



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

*Komisioni i Ceshtjeve Kushtetuese dhe Ligjore*

**RELACION PER DEKRETIN E PRESIDENTIT TE REPUBLIKES PER  
KTHIMIN E LIGJIT NR. 9046 DATE 24.4.2003 "PER RATIFIKIMIN E  
MARRVESHJES NDERMJET MINISTRISE SE MBROJTJES SE  
REPUBLIKES SE SHQIPERISE DHE MINISTRISE SE MBROJTJES  
KOMBETARE TE GREQISE PER NDERTIMIN E KOMANDES DHE  
MJEDISEVE TE AKOMODIMIT TE PERSONELIT, SI DHE THELLIMIN E  
KANALIT HYRES TE BASENIT DETAR TE BISHTIT TE PALLES"**

Komisioni i Ceshtjeve Kushtetuese dhe Ligjore ne mbledhjen e tij te dates 2.6.2003 morri ne shqyrtim Dekretin e Presidentit te Republikes me ane te te cilit, ne baze te kompetences kushtetuese, kthen per rishqyrtim ne Kuvend ligjin nr. 9047 date 7.4.2003 "Relacion per Dekretin e Presidentit te Republikes per kthimin e ligjit nr. 9046 date 24.4.2003 "Per ratifikimin e marrveshjes ndermjet Ministrise se Mbrojtjes se Republikes se Shqiperise dhe Ministrise se Mbrojtjes Kombetare te Greqise per ndertimin e komandes dhe mjediseve te akomodimit te personelit, si dhe thellimin e kanalit hyres te basenit detar te Bishtit te Palles".

Komisioni i shqyrtoi argumentat e kthimit te ketij ligjit ne prani te perfaqesuesve te Presidentit, te Ministrit te Mbrojtjes dhe stafit te tij *dhe me shumice votash vendosi t'i propozoje seances plenare mosmiratimin e dekretit te Presidentit te Republikes.*

Ne rastin e marrveshjeve nderkombetare Kuvendi ne zbatim te kompetences se tij kushtetuese ka te drejte vetem te ratifikoje ose jo marrveshjen nderkombetare pa pasur te drejte te beje ndryshime te njeanshme ne tekstin e saj. Nga ana tjetere ne Komision nuk u perkrah ideja se mund te delegohet e drejta per te rinegociuar marrveshjen nga Qeveria si e pambeshtetur ne ligj. Qeveria e mbylli ciklin e negociatave dhe nenshkrimit te marrveshjes sipas ligjit "Per lidhjen e traktateve dhe marrveshjeve nderkombetare". Komisioni pas debatesh te shumta konkludoi se verejtjet qe parashtron Presidenti ne formulime teknike nuk krijojne mundesine e keqinterpretimeve ne praktike te marrveshjes ashtu edhe per shmangie te mundshme nga percaktimet kushtetuese.

Sipas nenit 85 pika 2 te Kushtetutes, ky dekret e humbet fuqine tij ne rast se ne séance plenare kunder tij votojne shumica e te gjithe anetareve te Kuvendit.

Kryetari

Spartak BRAHO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI  
*Komisioni i Mbrojtjes*

Tirane me, 03.06.2003

## RELACION

**PER DEKRETIN PER KTHIMIN E LIGJIT NR.9046, DATE 03.04.2003 "PER RATIFIKIMIN E MARREVESHJES, NDERMJET MINISTRISE SE MBROJTJES SE REPUBLIKES SE SHQIPERISE DHE MINISTRISE SE MBROJTJES KOMBETARE TE REPUBLIKES SE GREQISE, PER NDERTIMIN E GODINES SE KOMANDES DHE TE MJEDISEVE TE AKOMODIMIT TE PERSONELIT, SI DHE THELLIMI I KANALIT HYRES DHE TE BASENIT TE BAZES DETARE TE BISHT-PALLES".**

Komisioni i Mbrojtjes ne mbledhjen e datës 03.06.2003 morri ne shqyrtim Dekretin e Presidentit te Republikës se Shqipërisë "per kthimin e ligjit nr. 9046, date 3.04,2003 "Për ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes se Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës se Greqisë, për ndërtimin e Godinës së Komandës dhe të Mjediseve të Akomodimit të personelit, si dhe thellimi i kanalit hyrës dhe të basenit te bazës detare të Bisht-Pallës".

Komisioni pas diskutimesh te shumta ne prani te Ministrit te Mbrojtjes dhe specialisteve te Ministrise se Mbrojtjes u shpreh me shumice votash pro miratimit te Dekretit ne seance plenare . (Raporti i votimit ne komision ishte 6 vota pro miratimit te dekretit dhe dy vota kunder miratimit te dekretit).

Per voten kunder deputetet do të shprehen edhe në seancë plenare.

**KRYETARI**

**Dashamir SHEHI**